



# **UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

## **RAPORT I HULUMTIMIT**

**Shkalla e vaksinimit kundër COVID-19 e stafit  
akademik dhe administrativ të Universitetit të  
Prishtinës “Hasan Prishtina”**

**Prishtinë, 14 Shtator 2021**

## **PËRMBLEDHJE**

Sipas vendimit nr. 01/32 të datës 28.8.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke filluar nga data 13 shtator 2021, të gjithë punonjësit e institucioneve publike dhe private duhet të posedojnë certifikatën e vaksinimit apo dëshmitë që tregojnë se janë negativ për COVID-19, në mënyrë që t'ju lejohet hyrja në ambientet e punës.

Për të pasur një pasqyrë më të qartë për shkallën e vaksinimit kundër COVID-19 të stafit akademik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe për të planifikuar skenarët e mundshëm të organizimit të procesit mësimor dhe shërbimeve administrative me studentë gjatë semestrit vjeshtor të vitit akademik 2021/2022, nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” (UP) u dizajnuar hulumtimi me titull “*Shkalla e vaksinimit kundër COVID-19 e stafit akademik dhe administrativ të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”*”.

Pyetëtori i dizajnuar për këtë hulumtim është përgatitur në formatin elektronik ([doc.google.com/forms](https://doc.google.com/forms)), është shpërndarë përmes email adresës, dhe si të plotësuar në mënyrë korrekte janë vlerësuar 541 pyetësorë nga stafi akademik dhe 101 pyetësorë nga stafi administrativ i UP-së; të dhënat e këtyre pyetësorëve (të anketuarve) janë përpunuar në mënyrë statistikore. Hulumtimi është kryer në periudhën nga 3.9.2021 deri më 10.9.2021. Gjatë përgatitjes së këtij raporti janë përdorur vetëm të dhënat primare (të mbledhura përmes pyetësorit të plotësuar nga të anketuarit).

Ky hulumtim ka gjetur shkallë të lartë vaksinimit të stafit akademik, nga të cilët madje 82.6 % e stafit akademik kanë rezultuar plotësisht të vaksinuar, 12.9% e tyre pjesërisht të vaksinuar por që deri më 1 tetor planifikohet të jenë plotësisht të vaksinuar, ndërsa vetëm 4.4 % janë deklaruar si të pavaksinuar. Ngjashëm, edhe në mesin e stafit administrativ të anketuar, shumica dërmuese e tyre janë deklaruar si plotësisht të vaksinuar (50.5%) apo pjesërisht të vaksinuar (35.6%), ndërsa të pavaksinuar janë deklaruar 13.9% nga ta.

Gjetje tjetër me rëndësi e këtij hulumtimi është dhe gatishmëria e lartë e stafit akademik dhe administrativ për të filluar procesin mësimor dhe shërbimet administrative me prani fizike nga 1 Tetori 2021, nëse shkalla e vaksinimit e këtyre grupeve të përfshirë në anketë dhe e studentëve rezulton e kënaqshme dhe numri i infeksioneve me SARS COV2 (COVID-19) bjen ndjeshëm.

## **METODOLOGJIA E HULUMTIMIT**

Ky hulumtim i realizuar është i tipit cross-sectional, është kryer nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, ndërsa pjesëmarrës kanë qenë stafi akademik dhe administrativ i këtij institucioni të arsimit të lartë.

Hulumtimi u krye në periudhën nga 3.9.2021 deri më 10.9.2021, ku linku për pyetësin i'u shpërnda drejtpërdrejt stafit akademik përmes email adresës [personeli@uni-pr.edu](mailto:personeli@uni-pr.edu). Stafi akademik janë lutur që të plotësojnë dhe dërgojnë (submit) pyetësin e dizajnuar për këtë qëllim, duke klikuar në linkun: [https://docs.google.com/forms/d/1rouwrrOO6qMBDq\\_RBdMG-TIXwTKdcuuWRx-UNkrBuc/edit?usp=sharing](https://docs.google.com/forms/d/1rouwrrOO6qMBDq_RBdMG-TIXwTKdcuuWRx-UNkrBuc/edit?usp=sharing). Me datën 9.9.2021 stafit akademik i'u është dërguar edhe një rikujtim për plotësim të pyetësit.

Në kuadër të UP-së funksionojnë katërmbëdhjetë (14) njësi akademike dhe rreth 900 veta si staf akademik i rregullt në thirrje të ndryshme akademike. Gjatë periudhës sa ka qenë e hapur mundësia për plotësim të pyetësit, 541 persona nga stafi akademik i UP-së e kanë plotësuar atë.

Gjatë së njëjtës periudhe kohore, për të hulumtuar edhe shkallën e vaksinimit të stafit administrativ të UP-së, linku i pyetësit i përshtatur për ta u është shpërndarë drejtpërdrejt në email adresat e tyre zyrtare: [https://docs.google.com/forms/d/1C8qqycu9wyWH3PEEZEQnvgz-LKk\\_I739HTO3L-Ws\\_Ew/edit?usp=sharing](https://docs.google.com/forms/d/1C8qqycu9wyWH3PEEZEQnvgz-LKk_I739HTO3L-Ws_Ew/edit?usp=sharing). Gjatë periudhës sa ka qenë e hapur mundësia për plotësim të pyetësit, 101 persona nga stafi administrativ i UP-së e kanë plotësuar atë.

Në fillim të pyetësit janë përfshirë të dhënat bazike demografike (gjina, grupmosha, njësi akademike të cilës i përkasin dhe titulli akademik në UP përkatësisht komponenta administrative e UP së cilës i përkasin), ndërsa për të vlerësuar shkallën e vaksinimit dhe qëndrimet e të anketuarve rreth mundësisë së fillimit të procesit mësimor me prani fizike, në pyetësor janë përfshirë pyetje specifike, të cilat mund të shihen në pyetësoret e bashkëngjitur në fund të këtij raporti. Të gjithë të anketuarve u janë dhënë sqarime të shkurtëra rreth studimit dhe u është konfirmuar se pyetësorët janë anonim.

Përpunimi i të dhënave të mbledhura është kryer me programin statistikor SPSS, ndërsa të dhënat kategorike janë prezantuar si frekuenca absolute dhe relative, për UP-në si tërësi dhe për njësi akademike të veçanta.

## REZULTATET E HULUMTIMIT

Në këtë hulumtim janë përfshirë 541 të anketuar nga stafi akademik dhe 101 të anketuar nga stafi administrativ i UP-së. Siç shihet në tabelën 1, ku është dhënë pjesëmarrja gjinore, shumica e stafit akademik dhe administrativ të cilët e kanë plotësuar pyetësorin janë meshkuj (n=319, 59%, përkatësisht n=54, 53.5%).

**Tabela 1. GJINIA E PJESEMARRËSVE**

	Stafi akademik		Stafi administrativ	
	Numri	Përqindja	Numri	Përqindja
Femra	222	41.0	47	46.5
Meshkuj	319	59.0	54	53.5
<b>Gjithsej</b>	<b>541</b>	<b>100</b>	<b>101</b>	<b>100</b>

Në këtë hulumtim kanë marrë pjesë individë të të gjitha grupmoshave, ku pjesa dërmuese e tyre u takojnë grupmoshave nën 40 vjeç dhe 40 deri 50 vjeç (tabela 2).

**Tabela 2. KARAKTERISTIKAT E PJESEMARRËSVE SIPAS GRUPMOSHAVE**

	Stafi akademik		Stafi administrativ	
	Numri	Përqindja	Numri	Përqindja
Nën 40 vjeç	139	25.7	44	43.6
40 deri 50 vjeç	190	35.1	37	36.6
51 deri 60 vjeç	136	25.1	13	12.9
Mbi 60 vjeç	76	14.0	7	6.9
<b>Gjithsej</b>	<b>541</b>	<b>100</b>	<b>101</b>	<b>100</b>

Sa i takon përkatësisë së njësisë akademike përkatësisht komponentës administrative të UP-së, siç kuptohet nga tabela 3, rezulton që shumica e të anketuarve nga stafi akademik që e kanë plotësuar pyetësorin i takojnë Fakultetit të Mjekësisë (n=112, 20.7%), ndërsa numri më i vogël i të anketuarve ka qenë nga Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sporteve (n=9, 1.7%), që ndoshta mund të shpjegohet me stafin akademik më të paktë që mund të ketë kjo njësi akademike. Sa i takon stafit administrativ, çereku i të anketuarve i takojnë Administratës Qendrore (n=25, 24.8%), ndërsa pjesa tjetër i takon administratës së njësive akademike të UP-së.

**Tabela 3. SHPËRNDARJA E PJESËMARRËSVE SIPAS NJËSIVE AKADEMIKE/KOMPONENTËS ADMINISTRATIVE**

	Stafi akademik		Stafi administrativ	
	Numri	Përqindja	Numri	Përqindja
Fakulteti Filozofik	47	8.7	8	7.9
Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	60	11.1	6	5.9
Fakulteti i Filologjisë	52	9.6	12	11.9
Fakulteti Juridik	25	4.6	10	9.9
Fakulteti Ekonomik	35	6.5	13	12.9
Fakulteti i Ndërtimtarisë	30	5.5	7	6.9
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	28	5.2	5	5
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	28	5.2	5	5
Fakulteti i Mjekësisë	112	20.7	1	1
Fakulteti i Arteve	34	6.3	4	4
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	31	5.7	2	2
Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit	9	1.7	2	2
Fakulteti i Edukimit	36	6.7	-	-
Fakulteti i Arkitekturës	14	2.6	1	1
Administrata Qendrore e UP-së	-	-	25	24.8
<b>Gjithsej</b>	<b>541</b>	<b>100</b>	<b>101</b>	<b>100</b>

Në tabelën 4 janë prezantuar titujt akademik konform statutit të UP-së, të stafit akademik që e kanë plotësuar këtë pyetësor, ndër të cilët shumica dërmuese e tyre janë staf i rregullt, ndërsa 16 nga ta janë deklaruar si bashkëpunëtorë të jashtëm (3%).

**Tabela 4. SHPËRNDARJA E PJESËMARRËSVE SIPAS TITUJVE AKADEMIK**

	Numri	Përqindja
Profesor i rregullt	109	20.1
Profesor i asocuar	107	19.8
Profesor asistent	160	29.6
Asistent universiteti	139	25.7
Lektor apo Korepetitor (Fakulteti i Arteve)	10	1.8
Bashkëpunëtor i jashtëm	16	3.0
<b>Gjithsej</b>	<b>541</b>	<b>100</b>

Nga rezultatet e tabelës 5, shihet se një numër dukshëm më i madh i stafit akademik pjesëmarrës në hulumtim kanë raportuar se janë plotësisht të vaksinuar (n=447, 82.6%), pasuar nga ata që janë pjesërisht të vaksinuar por që deri më 1 tetor planifikohet të jenë plotësisht të vaksinuar (n=70, 12.9%) , ndërsa se nuk janë të vaksinuar kanë raportuar 24 të anketuar (4.4%). Nga ana tjetër, në mesin e stafit administrativ të UP-së është raportuar se 51 të anketuar janë plotësisht të vaksinuar (50.5%), 36 të anketuar janë pjesërisht të vaksinuar (35.6%), ndërsa të pavaksinuar janë deklaruar 14 prej tyre (13.9%).

**Tabela 5. SHPËRNDARJA E PJESËMARRËSVE SIPAS KATEGORISË SË VAKSINIMIT**

	Stafi akademik		Stafi administrativ	
	Numri	Përqindja	Numri	Përqindja
Plotësisht i vaksinuar (dy doza të administruara të vaksinës)	447	82.6	51	50.5
Pjesërisht i vaksinuar (një dozë e administruar e vaksinës) por deri më 1 Tetor planifikoj të jem plotësisht i vaksinuar	70	12.9	36	35.6
I pavaksinuar	24	4.4	14	13.9
<b>Gjithsej</b>	<b>541</b>	<b>100</b>	<b>101</b>	<b>100</b>

Në pyetjen e parashtruar për të gjetur arsyen e mosvaksinimit të stafit akademik që janë deklaruar si të pavaksinuar, 14 të anketuar (2.6%) kanë raportuar se kanë termin ditëve në vijim për vaksinim me dozën e parë, 5 nga ta (0.9%) janë shprehur që kanë provuar të caktojnë termin për vaksinim por ka qenë e pamundur, ndërsa 4 të anketuar (0.7%) kanë deklaruar se nuk planifikojnë të

vaksinohen, duke përmendur si arsye se ditëve të fundit sapo e kanë kaluar COVID-19 (n=3) apo se janë shtatzanë dhe nuk i'u është rekomanduar vaksinimi nga ana e gjinekologut-obstetrit (n=1). Në mënyrë të ngjashme, stafi administrativ i pavaksinuar kanë deklaruar se kanë termin ditëve në vijim për vaksinim me dozën e parë (n=8, 53%) ose se kanë provuar të caktojnë termin për vaksinim por ka qenë e pamundur (n=7, 46.7%).

Me këtë hulumtim është vlerësuar edhe gatishmëria e stafit akademik dhe administrativ për të filluar procesin mësimor dhe shërbimet administrative me prani fizike, nëse shkalla e vaksinimit e këtyre grupeve të përfshirë në anketë dhe e studentëve rezulton e kënaqshme dhe numri i infeksioneve me SARS COV2 (COVID-19) bjen ndjeshëm (tabela 6). Madje 84.5 % e të anketuarve janë përgjigjur se janë shumë të gatshëm apo të gatshëm për proces mësimor me prani fizike, ndërsa 15.5 % e tyre janë deklaruar si jo të gatshëm dhe preferojnë që procesi mësimor të mbahet online. Gatishmëri e ngjashme për shërbime administrative me prani fizike është raportuar edhe nga stafi administrativ, nga të cilët 93.1% janë përgjigjur se janë shumë të gatshëm apo të gatshëm për shërbime administrative me prani fizike, ndërsa 6.9 % e tyre janë deklaruar si jo të gatshëm.

**Tabela 6. GATISHMËRIA E PJESËMARRËSVE PËR PROCES MËSIMOR/SHËRBIME ADMINISTRATIVE ME PRANI FIZIKE**

	Stafi akademik		Stafi administrativ	
	Numri	Përqindja	Numri	Përqindja
Shumë i gatshëm	270	49.9	36	35.6
I gatshëm	187	34.6	58	57.4
Jo i gatshëm, dhe preferoj që procesi mësimor të mbahet online	84	15.5	7	6.9
<b>Gjithsej</b>	<b>541</b>	<b>100</b>	<b>101</b>	<b>100</b>

## **PËRFUNDIMI**

Të gjitha dëshmitë në dispozicion tregojnë se mënyra më e mirë për të mbrojtur shëndetin publik gjatë pandemisë COVID-19 është të kesh një shkallë shumë të lartë vaksinimi. Mosdiponueshmëria adekuatë e vaksinave dhe në një masë më të vogël dezinformatat dhe brengat e sigurisë në lidhje me vakcina specifike ishin sfida fillestare të konsiderueshme të fushatës së vaksinimit masiv, që synon të arrijë 70% të mbulimit të përgjithshëm të popullsisë sonë me vaksinë kundër COVID-19. Përkundër të gjithave, këto ditë është kaluar numri prej 1 milion vaksinash të administruara në Republikën e Kosovës. Në këtë drejtim, në bazë të gjetjeve të këtij hulumtimi, shkalla e vaksinimit e stafit akademik dhe administrativ të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” është e lartë, që është një faktor që na siguron që rreziku nga infeksioni serioz me COVID-19 të mbetet i ultë.

Përveç kësaj, gatishmëria e lartë e stafit akademik dhe administrativ për të filluar procesin mësimor dhe shërbimet administrative me prani fizike, e bën të domosdoshme që shkalla e vaksinimit të studentëve të jetë po ashtu në nivel të lartë. Për këtë arsye, rekomandohet që të vazhdohet me fushatë më intenzive senzibilizimi rreth përfitimeve të vaksinimit edhe të studentëve, aq më tepër që tani, për t’u qasur në institucione, certifikata e vaksinimit është një ndër dëshmitë që kërkohet sipas vendimit të fundit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 01/35, të datës 12.09.2021.



**ANEKSI 1. SHPËRNDARJA E PJEËMARRËSVE SIPAS KATEGORISË SË VAKSINIMIT NË NJËSITË AKADEMIKE TË UP-së**

**1. FAKULTETI FILOZOFIK**

	Stafi akademik	
	Numri	Përqindja
Plotësisht i vaksinuar (dy doza të administruara të vaksinës)	42	89.4
Pjesërisht i vaksinuar (një dozë e administruar e vaksinës) por deri më 1 Tetor planifikoj të jem plotësisht i vaksinuar	4	8.5
I pavaksinuar	1	2.1
<b>Gjithsej</b>	<b>47</b>	<b>100</b>

**2. FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE**

	Stafi akademik	
	Numri	Përqindja
Plotësisht i vaksinuar (dy doza të administruara të vaksinës)	47	78.3
Pjesërisht i vaksinuar (një dozë e administruar e vaksinës) por deri më 1 Tetor planifikoj të jem plotësisht i vaksinuar	11	18.3
I pavaksinuar	2	3.3
<b>Gjithsej</b>	<b>60</b>	<b>100</b>

**3. FAKULTETI I FILOLOGJISË**

	Stafi akademik	
	Numri	Përqindja
Plotësisht i vaksinuar (dy doza të administruara të vaksinës)	41	78.8
Pjesërisht i vaksinuar (një dozë e administruar e vaksinës) por deri më 1 Tetor planifikoj të jem plotësisht i vaksinuar	5	9.6
I pavaksinuar	6	11.5
<b>Gjithsej</b>	<b>52</b>	<b>100.0</b>

#### 4. FAKULTETI JURIDIK

	Stafi akademik	
	Numri	Përqindja
Plotësisht i vaksinuar (dy doza të administruara të vaksinës)	19	76.0
Pjesërisht i vaksinuar (një dozë e administruar e vaksinës) por deri më 1 Tetor planifikoj të jem plotësisht i vaksinuar	4	16.0
I pavaksinuar	2	8.0
<b>Gjithsej</b>	<b>25</b>	<b>100.0</b>

#### 5. FAKULTETI EKONOMIK

	Stafi akademik	
	Numri	Përqindja
Plotësisht i vaksinuar (dy doza të administruara të vaksinës)	30	85.7
Pjesërisht i vaksinuar (një dozë e administruar e vaksinës) por deri më 1 Tetor planifikoj të jem plotësisht i vaksinuar	5	14.3
I pavaksinuar	-	-
<b>Gjithsej</b>	<b>35</b>	<b>100.0</b>

#### 6. FAKULTETI I NDËRTIMTARISË

	Stafi akademik	
	Numri	Përqindja
Plotësisht i vaksinuar (dy doza të administruara të vaksinës)	25	83.3
Pjesërisht i vaksinuar (një dozë e administruar e vaksinës) por deri më 1 Tetor planifikoj të jem plotësisht i vaksinuar	4	13.3
I pavaksinuar	1	3.3
<b>Gjithsej</b>	<b>30</b>	<b>100.0</b>

## 7. FAKULTETI I INZHINIERISË ELEKTRIKE DHE KOMPJUTERIKE

	Stafi akademik	
	Numri	Përqindja
Plotësisht i vaksinuar (dy doza të administruara të vaksinës)	25	89.3
Pjesërisht i vaksinuar (një dozë e administruar e vaksinës) por deri më 1 Tetor planifikoj të jem plotësisht i vaksinuar	2	7.1
I pavaksinuar	1	3.6
<b>Gjithsej</b>	<b>28</b>	<b>100.0</b>

## 8. FAKULTETI I INZHINIERISË MEKANIKE

	Stafi akademik	
	Numri	Përqindja
Plotësisht i vaksinuar (dy doza të administruara të vaksinës)	22	78.6
Pjesërisht i vaksinuar (një dozë e administruar e vaksinës) por deri më 1 Tetor planifikoj të jem plotësisht i vaksinuar	4	14.3
I pavaksinuar	2	7.1
<b>Gjithsej</b>	<b>28</b>	<b>100.0</b>

## 9. FAKULTETI I MJEKËSISË

	Stafi akademik	
	Numri	Përqindja
Plotësisht i vaksinuar (dy doza të administruara të vaksinës)	100	89.3
Pjesërisht i vaksinuar (një dozë e administruar e vaksinës) por deri më 1 Tetor planifikoj të jem plotësisht i vaksinuar	9	8.0
I pavaksinuar	3	2.7
<b>Gjithsej</b>	<b>112</b>	<b>100.0</b>

## 10. FAKULTETI I ARTEVE

	Stafi akademik	
	Numri	Përqindja
Plotësisht i vaksinuar (dy doza të administruara të vaksinës)	27	79.4
Pjesërisht i vaksinuar (një dozë e administruar e vaksinës) por deri më 1 Tetor planifikoj të jem plotësisht i vaksinuar	6	17.6
I pavaksinuar	1	2.9
<b>Gjithsej</b>	<b>34</b>	<b>100.0</b>

## 11. FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË

	Stafi akademik	
	Numri	Përqindja
Plotësisht i vaksinuar (dy doza të administruara të vaksinës)	24	77.4
Pjesërisht i vaksinuar (një dozë e administruar e vaksinës) por deri më 1 Tetor planifikoj të jem plotësisht i vaksinuar	5	16.1
I pavaksinuar	2	6.5
<b>Gjithsej</b>	<b>31</b>	<b>100.0</b>

## 12. FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT

	Stafi akademik	
	Numri	Përqindja
Plotësisht i vaksinuar (dy doza të administruara të vaksinës)	7	77.8
Pjesërisht i vaksinuar (një dozë e administruar e vaksinës) por deri më 1 Tetor planifikoj të jem plotësisht i vaksinuar	-	-
I pavaksinuar	2	22.2
<b>Gjithsej</b>	<b>9</b>	<b>100.0</b>

### 13. FAKULTETI I EDUKIMIT

	Stafi akademik	
	Numri	Përqindja
Plotësisht i vaksinuar (dy doza të administruara të vaksinës)	25	69.4
Pjesërisht i vaksinuar (një dozë e administruar e vaksinës) por deri më 1 Tetor planifikoj të jem plotësisht i vaksinuar	10	27.8
I pavaksinuar	1	2.8
<b>Gjithsej</b>	<b>36</b>	<b>100.0</b>

### 14. FAKULTETI I ARKITEKTURËS

	Stafi akademik	
	Numri	Përqindja
Plotësisht i vaksinuar (dy doza të administruara të vaksinës)	13	92.9
Pjesërisht i vaksinuar (një dozë e administruar e vaksinës) por deri më 1 Tetor planifikoj të jem plotësisht i vaksinuar	1	7.1
I pavaksinuar	-	-
<b>Gjithsej</b>	<b>14</b>	<b>100.0</b>

## **ANEKSI 2. Pyetësi: SHKALLA E VAKSINIMIT KUNDËR COVID-19 E STAFIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

Ky pyetësor është plotësisht anonim dhe do të përdoret nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për të përcaktuar shkallën e vaksinimit kundër COVID-19 të personelit akademik.

Gjetjet e këtij hulumtimi do të ndihmojnë menaxhmentin e UP-së që të planifikojë skenarët e mundshëm të organizimit të procesit mësimor gjatë semestrit vjeshtor të vitit akademik 2021/2022.

Gjatë plotësimit të këtij pyetësi, udhëzoheni që të secila pyetje e parashtruar të përzgjidhni vetëm njërin nga alternativat.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin tuaj, ju njoftojmë se plotësimi i këtij pyetësi merr midis 1 dhe 2 minutash.

### 1. Gjinia juaj?

- Femër
- Mashkull

### 2. Grupmosha juaj?

- Nën 40 vjeç
- 40 - 50 vjeç
- 51 - 60 vjeç
- Mbi 60 vjeç

### 3. Cilës Njësi Akademike të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” i përkisni?

- Fakulteti Filozofik
- Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore
- Fakulteti i Filologjisë
- Fakulteti Juridik
- Fakulteti Ekonomik
- Fakulteti i Ndërtimtarisë
- Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike
- Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
- Fakulteti i Mjekësisë
- Fakulteti i Arteve
- Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
- Fakulteti i Edukatës Fizike dhe Sporteve
- Fakulteti i Edukimit
- Fakulteti i Arkitekturës

4. Titulli juaj akademik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina":

- Profesor i rregullt
- Profesor i asocuar
- Profesor asistent
- Asistent universiteti
- Lektor apo Korepetitor (Fakulteti i Arteve)
- Bashkëpunëtor i jashtëm

5. Në cilën nga kategoritë e mëposhtme sa i takon vaksinimit bëni pjesë?

- Plotësisht i vaksinuar (dy doza të administruara të vaksinës)
- Pjesërisht i vaksinuar (një dozë e administruar e vaksinës) por deri më 1 Tetor planifikoj të jem plotësisht i vaksinuar
- I pavaksinuar

6. Nëse në pyetjen paraprake jeni përgjigjur se i takoni kategorisë së të pavaksinuarve, ju lusim të përgjigjeni cila mund të jetë arsyeja për mosvaksinim?

- Kam termin të caktuar ditëve në vijim për vaksinim me dozën e parë
- Kam provuar të caktojë termin për vaksinim por ka qenë e pamundur
- Nuk planifikoj të vaksinohem

7. Nëse në pyetjen paraprake jeni përgjigjur se nuk planifikoni të vaksinoheni, ju lusim të shkruani arsyen/arsyet e mundshme (me pak fjalë):

\_\_\_\_\_

8. Nëse shkalla e vaksinimit të personelit akademik dhe e studentëve rezulton e kënaqshme dhe numri i infeksioneve të reja me SARS COV2 (COVID-19) bjen ndjeshëm, sa jeni të gatshëm për të filluar procesin mësimor me 1 Tetor me prani fizike?

- Shumë i gatshëm
- I gatshëm
- Jo i gatshëm, dhe preferoj që procesi mësimor të mbahet online

### **ANEKSI 3. Pyetësori: SHKALLA E VAKSINIMIT KUNDËR COVID-19 E STAFIT ADMINISTRATIV TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

Ky pyetësor është plotësisht anonim dhe do të përdoret nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për të përcaktuar shkallën e vaksinimit kundër COVID-19 të personelit administrativ. Gjetjet e këtij hulumtimi do të ndihmojnë menaxhmentin e UP-së që të planifikojë skenarët e mundshëm të ofrimit të shërbimeve administrative për studentë gjatë semestrit vjeshtor të vitit akademik 2021/2022.

Gjatë plotësimit të këtij pyetësori, udhëzoheni që të secila pyetje e parashtruar të përzgjidhni vetëm njërën nga alternativat.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin tuaj, ju njoftojmë se plotësimi i këtij pyetësori merr midis 1 dhe 2 minutash.

#### 1. Gjinia juaj?

- Femër
- Mashkull

#### 2. Grupmosha juaj?

- Nën 40 vjeç
- 40 - 50 vjeç
- 51 - 60 vjeç
- Mbi 60 vjeç

#### 3. Cilës komponentë administrative të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” i përkisni?

- Administrata Qendrore e UP-së
- Fakulteti Filozofik
- Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore
- Fakulteti i Filologjisë
- Fakulteti Juridik
- Fakulteti Ekonomik
- Fakulteti i Ndërtimtarisë
- Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike
- Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
- Fakulteti i Mjekësisë
- Fakulteti i Arteve
- Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
- Fakulteti i Edukatës Fizike dhe Sporteve
- Fakulteti i Edukimit
- Fakulteti i Arkitekturës



4. Në cilën nga kategoritë e mëposhtme sa i takon vaksinimit bëni pjesë?
- Plotësisht i vaksinuar (dy doza të administruara të vaksinës)
  - Pjesërisht i vaksinuar (një dozë e administruar e vaksinës) por deri më 1 Tetor planifikoj të jem plotësisht i vaksinuar
  - I pavaksinuar
5. Nëse në pyetjen paraprake jeni përgjigjur se i takoni kategorisë së të pavaksinuarve, ju lusim të përgjigjeni cila mund të jetë arsyeja për mosvaksinim?
- Kam termin të caktuar ditëve në vijim për vaksinim me dozën e parë
  - Kam provuar të caktojë termin për vaksinim por ka qenë e pamundur
  - Nuk planifikoj të vaksinohem
6. Nëse në pyetjen paraprake jeni përgjigjur se nuk planifikoni të vaksinoheni, ju lusim të shkruani arsyen/arsyet e mundshme (me pak fjalë):
- 
7. Nëse shkalla e vaksinimit të personelit administrativ, personelit akademik dhe e studentëve rezulton e kënaqshme dhe numri i infeksioneve të reja me SARS COV2 (COVID-19) bjen ndjeshëm, sa jeni të gatshëm për të filluar me shërbime administrative me 1 Tetor me prani fizike të plotë?
- Shumë i gatshëm
  - I gatshëm
  - Jo i gatshëm

